

Dep.	DPK	Nr. list.	03/4332/R
Dep.		Nr. list.	20-12-13
Nr. list.			
Broj. shpreh.			
Nr. parast.			

Nr.483/05-2012

Gjykata themelore-Departamenti i përgjithshëm-Divizioni për kundërvajtje në Prizren, me gjyqtarin Alija Fazlji, në procedurën e kundërvajtjes kundër pandehurës Fidan Jilta nga Prizreni, për shkak të kundërvajtjes nga nen.5, 6 par.1.3 dhe nen.9 e dënueshme sipas nen.17 par.1.3 të Ligjit mbi deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasuris zyrtarëve të lart publik, dhe deklarata mbi prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar (Z.04/L-050), e në bazë të nen.195 Ligjit mbi kundërvajtjet, më 29.11.2013, morri

AKTVENDIM

E pandehura Fidan Jilta, nga babai Sulejman, e lindur më 22.02.1971 në Prizren, me banes në rr.Vatrat Shqiptare, nr.64

Ë s h t ë P ë r g j e g j ë s e

Sepese në afatin ligjor deri më 31.03.2012, si nëpunëse publike e lartë shtetërore pranë Kuvendit të Prizrenit, Agjencionit kundër korrupsionit nuk dorëzoi formularin mbi deklarimin e pasuris.

- me çka ka kryer kundërvajtje nga nen.5, 6 par.1.3 dhe nen.9 e dënueshme sipas nen.17 par.1.3 të Ligjit mbi deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasuris zyrtarëve të lartë publik, dhe deklarata mbi prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për gjithë personat zyrtar (Z.04/L-050), për këtë me zbatimin e nen.9. par.1.pik.të Ligjit mbi kundërvajtjet

D Ë N O H E T

ME GJOBË NË TË HOLLA në shumë prej 300 (treqind) €.

E pandehura detyrohet që dënimin e shqiptuar me gjobë të pagoi në afat prej 15 ditëve me plotfuqishmërin e aktvendimit, në të kundërtën shqiptimi i dënimit me gjobë do të zëvendësohet me dënimin me burg ashtu që për çdo 20 € dënimin me gjobë caktohet një ditë burg. E pandehura detyrohet që në afatin e njëjtë të pagoi shpenzimet e procedurës në shumën paushalle prej 5 €, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë. E pandehura detyrohet që me kryerjen e pagesës së dënimit me gjobë dhe shpenzimet e procedurës, për këtë të njoftoi gjykatën.

Ar sy e t i m i

Sipas kërkesës së Agjencionit kundër korrupsionit me seli në Prishtinë, nr.01-1898/2012 prej ditës 24.05.2012, është filluar procedura e kundërvajtjes kundër pandehurës Fidan Jilta nga Prizreni, për shkak kundërvajtjes nga nen.5, 6 par.1.3 dhe nen.9 e dënueshme sipas nen.17 par.1.3 të Ligjit mbi deklarimin, prejardhjen dhe kontrollën e pasurisë zyrtarëve të lartë publik, dhe deklarata mbi prejardhjen dhe kontrollën e dhuratave për të gjithë personat zyrtar (Z.04/L-050).

E pandehura në mbrojtjen e vetë ka deklaruar që në fillim të punës si këshilltare në Kuvendin e Prizrenit, më 15.02.2010 Agjencionit kundër korrupsionit paraqiti formularin mbi pasurinë, por më vonë nga askush nuk pranoi kursesi kërkesë për lajmërimin e pasurisë, si dhe porsa me ardhjen në gjykatë mësoi se Agjencioni kundër korrupsionit ka parashtruar kërkesën për fillimin e procedurës së kundërvajtjes kundër saj, si dhe pas kësaj më 01.10.2010 Agjencionit kundër korrupsionit paraqiti formularin e plotësuar mbi pasurinë, si dhe provën kësaj gjykate paraqiti në shiqim vërtetimin nr. 03-3743/2012 prej 01.10.2012, lëshuar nga ana e Agjencionit të përmendur.

Me shiqimin në vërtetimin e paraqitur nr. 03-3743/2012 e lëshuar nga ana e Agjencionit kundër korrupsionit u vërtetue që e pandehura Fidan Jilta formularin e plotësuar mbi pasurinë të njejtë e dorëzoi më 01.10.2012, e me shiqimin në vërtetimin nr.604/2013 prej 21.10.2013 e lëshuar nga ana shkollës “Emin Duraku” në Prizren, është vërtetuar se e pandehura Fidan Jilta punon si profesoreshë në njejtën, me pagën mujore prej 387,50 (treqindetëdhjeteshtatë e pesëdhjet) €.

Për vërtetimin e gjendjes faktike në plotësi gjykata në cilsin e dëshmitarit dëgjoji Agron Bajramin, shef i departamentit në Agjencionin kundër korrupsionit dhe i njëjti deklaroi se çdo vjet që çdo vjet, në muajin Mars, mbajnë mbledhje me zyrtarin i ngarkuar për kontakte në çdo institucion, në të cilën punojnë zyrtarët e lartë publik, dhe prej atij kërkojnë listën me emërat e zyrtarëve të lartë publik, si dhe i njoftojnë mbi detyrimin e lajmërimit së pasurisë deri në fund të muajit Mars, si dhe që, Agjencioni gjithashtu lajmërimin e dërgon me postë elektronike dhe njëjtën e shpallin edhe në mjetet e informimit, si dhe që e pandehura Fidan Jilta, në afatin ligjor deri më 31.03.2012 Agjencionit kundër korrupsionit në Prishtinë nuk dorëzoi formularin e plotësuar mbi pasurinë, për këtë shkak edhe paraqitën kërkesën për fillimin e procedurës për kundërvajtje kundër saj.

Duke vlerësuar deklaratën e pandehurës dhe me shiqimin në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës është vërtetuar se i pandehura ka kryer kundërvajtjen e cila me kërkesë i vihet në barrë, për shkak së cilës është shpallur fajtores dhe dënuar sipas ligjit, me atë që me rastin e vendosjes mbi lartësinë e dënimit me gjobë janë marrë parasysht rrethanat nga nen.7, me atë që asaj janë marrë parasysht gjendja ekonomike-se punon si profesoreshë me pagën mujore në shumë prej 387,50 €, si dhe me vonë ka dorëzue Agjencionit kundër korrupsionit formularin e pasurisë, prandaj për këtë me

zbatimin e nen.9 par.1 pik.1 të Ligjit mbi kundërvajtjet, dënimi me gjobë është zbutë me besueshmëri që me atë do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit.

Vendimi mbi shumën paushalle është marrë në bazë të nen.109 par.2 të LK-ës

Nga gjitha të paraqiturat është vendosur si në shqiptimin e aktvendimit.

**GJYKATA THEMELORE-DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM
DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE
Nr.483/05-2012**

Përkthyesi gjyqësor,
Kenan Hadri



Gjyqtari,
Alija Fazlji, d.v.

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi mund të deponohet ankesa Gjykatës së Apelacionit-Departamenti të përgjithshëm-seksioni për kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditëve, nga dita e pranimit këtij aktvendimi. Ankesa parashtrohet përmes kësaj gjykate pa pagesë takse.